



**TrafikuUrban**  
PRISHTINË

NDËRMARRJA PUBLIKE KOMUNALE  
MUNICIPALITY PUBLIC ENTERPRISE  
"TRAFIKU URBAN" SH.A.

Nr. 5213 dt. 10.11.2025

## N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. Prishtinë Plani i Biznesit për vitin 2026



## Përmbajtja

1. Përmbledhje Ekzekutive .....	3
2. Të Dhëna Mbi Ndërmarrjen .....	6
2.1 Lokacioni i ndërmarrjes .....	6
2.2 Detaje mbi regjistrimin e biznesit .....	6
2.2.1 Veprimtarit e ndërmarrjes: .....	6
3. Fjala Hyrëse nga Kryesuesi i Bordit .....	7
4. Plani Financiar për Vitin 2026 .....	8
5. Marrëveshje Bashkëpunimi me Palët e Treta .....	10
6. SWOT Analiza .....	11
7. Administrata .....	12
7.1 Burimet Njerëzore .....	12
7.2 Zyra Ligjore .....	15
7.3 Teknologjia Informative .....	17
7.4 Plani i Marketingut .....	19
7.5 Marketing komercial .....	20
7.6 Aplikacioni mobil dhe shpërndarja e informacionit .....	21
8. Transporti .....	24
9. Mirëmbajtja .....	27
9.1 Shërbimet Mbështetëse .....	32
10. Përfundim .....	34
Aneksi 1 Plani i Buxhetit për vitin 2026 .....	35

## 1. Përmbledhje Ekzekutive

Ndërmarrja Publike Komunale “Trafiku Urban” është themeluar për të ofruar shërbime të transportit publik të sigurta, të besueshme dhe efikase, në përputhje me prioritetet strategjike të Komunës së Prishtinës dhe duke pasur në fokus përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët. Si një ndërmarrje publike komunale, "Trafiku Urban" zhvillon dhe zbaton politikat operacionale dhe zhvillimore në bashkëpunim të ngushtë me Komunën, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve për qytetarët dhe ndërtimin e një sistemi modern dhe të qëndrueshëm të transportit urban.

Në vitin 2025, ndërmarrja ka operuar me një flotë prej 51 autobusësh të standardit Euro 6, duke kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së shërbimit në transportin publik. Në vitin 2026 “Trafiku Urban” planifikon ta plotësoj flotën me 30 autobusëve të rinj – përmes një kredie të siguruar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe kjo flotë e re do të përfshijë 24 autobusë dizel të standardit më të fundit Euro 6, dhe 6 autobusë elektrik, si hap i parë konkret drejt tranzicionit në një sistem transporti më të qëndrueshëm dhe miqësor ndaj mjedisit.

- **Për vitin 2026, objektivat strategjike të ndërmarrjes përfshijnë:**

- Zgjerimin dhe përmirësimin e rrjetit të linjave të transportit publik, ku me një flotë prej 81 autobusësh (51 aktualë plus 30 të rinj), do të mbulojmë më shumë se 50% të zonave dhe linjave kryesore të transportit publik në Prishtinë, duke respektuar dhe plotësuar shërbimet që ofrojnë operatorët privatë;

- Integrimin e sistemeve të avancuara digjitale për menaxhimin e flotës dhe informimin në kohë reale të udhëtarëve;

- Zhvillimin dhe zbatimin e sistemit të ri të biletimit elektronik përmes kuletës digjitale (aplikacioni e-bus), që do të mundësojë një përvojë më moderne dhe të lehtë për qytetarët;

- Sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të menaxhuar me efikasitet, të ardhurat që rrjedhin nga marrëveshja për shërbime publike (PSC), fokusim në përmbushjen pa vështirësi të detyrimeve kreditore që burojnë nga blerja e autobusëve të rinj, garantim në vazhdimësinë e shërbimit cilësor për qytetarët, rritjen e kapaciteteve të stafit dhe përmirësimin e proceseve të brendshme përmes trajnimeve, teknologjisë dhe reformave organizative;

- Rritjen e kapaciteteve të stafit dhe përmirësimin e proceseve të brendshme përmes trajnimeve të strukturuar dhe investimeve në zhvillimin profesional, si një investim i kthyeshëm që ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin operativ, cilësinë e shërbimeve dhe performancën afatgjatë të ndërmarrjes.

- **Misioni**

Të ofrojmë një shërbim të transportit publik të sigurt, të besueshëm, të qasshëm dhe miqësor ndaj mjedisit, duke vepruar në përputhje me interesin publik dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komunën e Prishtinës, për të përmbushur nevojat e qytetarëve dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës urbane.

- **Vizioni**

Të bëhemi zgjedhja e parë e qytetarëve për transport publik në Prishtinë, përmes një flote moderne, stafit profesional dhe shërbimeve të digjitalizuar, duke kontribuar në një qytet më të qëndrueshëm, më të pastër dhe më të qasshëm.

- **Objektivat Kryesore për vitin 2026**

- Zgjerimi i mbulueshmërisë së shërbimit, ku me një flotë prej 81 autobusësh (përfshirë 30 autobusët e rinj të financuar përmes BERZH) synohet mbulimi i mbi 50% të zonave dhe linjave të transportit publik në Prishtinë, në koordinim me operatorët privatë;

- Integrimi i teknologjisë së re, duke përfshirë sistemin e biletimit elektronik, menaxhimin digjital të flotës dhe informimin në kohë reale për udhëtarët, me qëllim përmirësimin e përvojës së përdoruesve;

- Futja e autobusëve elektrikë në operim, si pjesë e angazhimit për tranzicion drejt një transporti më të gjelbër dhe më të qëndrueshëm;

- Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare, përmes menaxhimit efikas të marrëveshjes PSC – burimit të vetëm por të qëndrueshëm të ardhurave – dhe përmbushjes pa vështirësi të detyrimeve kreditore që lidhen me blerjen e autobusëve të rinj;

- Rritja e cilësisë dhe efikasitetit të operacioneve, përmes përmirësimit të planifikimit të linjave, orareve dhe shërbimeve mbështetëse;

- Investimi në zhvillimin e kapaciteteve të stafit, përmes trajnimeve dhe përmirësimit të proceseve të brendshme, si një investim i kthyeshëm që ndikon drejtpërdrejt në performancën e ndërmarrjes;

- Forcimi i bashkëpunimit me Komunën e Prishtinës, për planifikimin strategjik, koordinimin e politikave të transportit dhe realizimin e projekteve të përbashkëta në të mirë të qytetarëve.

- **Të Dhëna Kyçe për vitin 2026**

- Të ardhurat e planifikuara (nga PSC): 15,518,735.00€ (bazuar në kilometrat e planifikuar për t'u përshkuar sipas marrëveshjes PSC), ndërsa në total duke i përfshirë edhe të hyrat tjera, nga bonusi(PSC), nga “kontrata në shtëpi” kapin shumën e planifikuar 16,493,635.00€;

- Numri i përgjithshëm i autobusëve në operim: 81 autobusë (51 aktualë + 30 të rinj në proces blerjeje: 24 dizel dhe 6 elektrik);

- Numri i linjave të mbuluara nga ndërmarrja mbi 50% të linjave të transportit publik sipas planit të mobilitetit si dhe rrjetit të ri të transportit publik;

- Rritja e parashikuar e udhëtarëve: +20% krahasuar me vitin 2025 (pas futjes në operim të autobusëve të rinj dhe përmirësimit të shërbimeve);

- Investimet kryesore për 2026: €10 milion në flotë të re autobusësh (e financuar përmes kredisë nga BERZH), përmirësime operative dhe trajnime për staf;

- Burimi kryesor i të ardhurave: Marrëveshja për Shërbime Publike (PSC) – pagesë për kilometër të kaluar të autobusëve;

- Objektiva kryesore financiare: Përbushje pa vështirësi e detyrimeve kreditore dhe mbajtja e stabilitetit operativ.

## 2. Të Dhëna Mbi Ndërmarrjen


NPK "Trafiku Urban" SH.A. në Prishtinë ushtron veprimtarinë e transportit për udhëtarë në linjat urbane dhe urbane-periferike me qëllim të organizimit dhe lehtësimit të jetës së qytetarëve dhe hyn në rangun e veprimtarive tjera shërbyese komunale.

Ky shërbim ka filluar të ofrohet në mënyrë të organizuar nga Komuna e Prishtinës nga data 01.04.1976 kur edhe "Trafiku Urban" SH.A. u themelua si Ndërmarrje Publike Komunale.





### 2.1 Lokacioni i ndërmarrjes

Trafiku Urban ndodhet në rrugën "Tahir Zajmi" e cila është në jugperëndim të qendrës së Prishtinës.

### 2.2 Detaje mbi regjistrimin e biznesit

	Emri i biznesit:	N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A.
	Lloji i biznesit:	Shoqëri Aksionare
	Vendndodhja e biznesit:	Rr. "Tahir Zajmi" nr.43, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
	Viti i regjistrimit:	1976

#### 2.2.1 Veprimtarit e ndërmarrjes:

- ✓ Veprimtaria kryesore-primare e NPK "Trafiku Urban" në Prishtinë është:
  -  Transporti rrugor urban dhe ndërurban i pasagjerëve.
- ✓ Veprimtaritë sekondare të ndërmarrjes janë:
  -  Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve
  -  Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve
  -  Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to.



### 3. Fjala Hyrëse nga Kryesuesi i Bordit

I nderuari Kryetar i Komunës së Prishtinës, të nderuar Komision i Aksionarëve, anëtarë të Bordit të Drejtorëve, përfaqësues institucional, bashkëpunëtorë dhe përfaqësues të menaxhmentit të ndërmarrjes.

Në cilësinë e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, më lejoni që në këtë përmbledhje të shënoj një moment të rëndësishëm në zhvillimin strategjik të ndërmarrjes sonë publike – miratimin e Draft Planit të Biznesit për vitin 2026 të N.P.K. “Trafiku Urban” Sh.A. Prishtinë. Ky dokument përfaqëson një plan të qartë dhe të mirëstrukturuar për konsolidimin dhe transformimin e ndërmarrjes në një shërbim publik më modern, më të qëndrueshëm dhe më të afërt me qytetarin.

Ky Plan është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Bordit të Drejtorëve, Zyrtarëve të Lartë, Menaxhmentit dhe njësisë profesionale të ndërmarrjes, duke reflektuar përkushtimin tonë të përbashkët për një zhvillim të qëndrueshëm institucional dhe për një sistem transporti publik që i përgjigjet nevojave të një Prishtine dinamike dhe në zgjerim të vazhdueshëm. Plani i Biznesit 2026 ka në thelb modernizimin e flotës së autobusëve, përmes blerjes së 30 Autobusëve të ri (24 dizel dhe 6 elektrik), të cilat do ta çojnë numrin total të Autobusëve në 81 mjete transporti. Ky është një hap i madh përpara drejt përmirësimit të cilësisë së shërbimit dhe në të njëjtën kohë një angazhim konkret në tranzicionin drejt transportit të gjelbër dhe respektimit të standardeve të qëndrueshmërisë mjedisore.

Në këtë plan pasqyrohet gjithashtu angazhimi për digjitalizimin e proceseve të operimit, përmes sistemit të ri të biletimit elektronik dhe aplikacionit mobil “e-bus”, që do të mundësojnë transparencë më të madhe, lehtësi për qytetarët dhe menaxhim më efikas të të hyrave. Një tjetër element thelbësor është forcimi i qëndrueshmërisë financiare, me theks në menaxhimin e kujdesshëm të marrëveshjes për shërbime publike (PSC), përmbushjen e detyrimeve kreditore dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimit cilësor për qytetarët e Prishtinës. Një vend të veçantë në këtë Plan zë edhe zhvillimi profesional i stafit, përmes trajnimeve dhe politikave të avancuara të burimeve njerëzore. Në këtë mënyrë, ndërmarrja synon të fuqizojë kapitalin njerëzor si themel i suksesit organizativ dhe i përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.

Në emër të Bordit të Drejtorëve, shpreh mirënjohje dhe vlerësim të sinqertë për Ushtruesin e Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv z. Qendrim Vitija dhe gjithë anëtarët e menaxhmentit për kontributin e dhënë në hartimin profesional të këtij dokumenti strategjik. Ky plan pasqyron qartë punën e koordinuar, përkushtimin dhe përgjegjësinë e secilit drejtues njësisë në drejtim të përgatitjes së një dokumenti të qëndrueshëm dhe të realizueshëm.

Gjithashtu, falënderoj kolegët e Bordit të Drejtorëve për bashkëpunimin, vlerësimet profesionale dhe qasjen konstruktive gjatë gjithë procesit të shqyrtimit të këtij drafti. Kontributi dhe uniteti ynë institucional janë garanci për një proces të suksesshëm të zbatimit të planit në praktikë.

Plani i Biznesit 2026, i ndërtuar në përputhje me politikat zhvillimore të Komunës së Prishtinës dhe me standardet bashkëkohore të menaxhimit të ndërmarrjeve publike, do të jetë një bazë solide për arritjen e objektivave strategjike, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe rritjen e besimit të qytetarëve në sistemin publik të transportit urban.

Në përfundim, ky plan nuk është vetëm një dokument financiar apo operacional – është një vizion i përbashkët për të ardhmen e transportit publik në Prishtinë, një angazhim për qytetarin dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të kryeqytetit.

Me respekt,

Ylber Çitaku

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

N.P.K. “Trafiku Urban” Sh.A. Prishtinë



## 4. Plani Financiar për Vitin 2026

Përshkrimi	Vlera (€)
Të ardhurat totale	16,110,467.00
Shpenzimet operative	11,854,659.00
Shpenzime të zhvlerësimit	1,900,000.00
Investime kapitale	630,000.00
Detyrime ndaj kredisë	1,600,000.00
<b>Totali i shpenzimeve, Investimeve dhe detyrimeve</b>	<b>15,984,659.00</b>
<b>Fitimi para tatimeve</b>	<b>125,808.00</b>
<b>Fitimi neto i parashikuar</b>	<b>125,808.00</b>

Tab. 1. Parashikimi i planit financiar për vitin 2026

Për vitin 2026, ndërmarrja parashikon të realizojë të ardhura në vlerën e 16.11 milionë eurove, me planifikimin e operimit të shtatëdhjetepesë (75) autobusëve dizel për vitin 2026 dhe 6 autobusëve elektrik, për të cilët është planifikuar të fillojnë operimin nga muaji prill i vitit 2026, ndërsa shpenzimet totale (përfshirë operative, zhvlerësim, investime dhe detyrime ndaj kredisë) llogariten rreth 15.98 milionë euro. Si rezultat, pritet një fitim neto prej 125 mijë eurosh. Kjo paraqet një performancë të qëndrueshme financiare dhe një bazë solide për rritje të mëtejshme, reflektuar në menaxhimin efikas të kostove dhe potencialeve të lartë për përfitime në treg.

- **Vlerësimi i Rrezikut dhe Strategjitë e Menaxhimit të Tij**

Identifikimi dhe menaxhimi i rreziqeve është thelbësor për qëndrueshmërinë dhe suksesin afatgjatë të ndërmarrjes. Më poshtë paraqiten rreziqet kryesore të identifikuara, së bashku me strategjitë për t'i menaxhuar ato në mënyrë efektive.

- **Rreziku Financiar (Plani për vitin 2026)**

Në planin financiar për vitin 2026, ndërmarrja parashikon një qarkullim të konsiderueshëm të ardhurave nga kontrata PSC, nga e cila kompensohemi për kilometra të kaluara nga autobusët në operim me çmim për km 2.708 euro. Pagesat zakonisht realizohen në baza mujore dhe kanë qenë të rregullta në vitet e mëparshme.

Megjithatë, përvoja e vitit 2025, ka treguar se rreziku nga vonesat në pagesa nuk është i përjashtuar, sidomos kur ato lidhen me faktorë institucionalë që janë jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të ndërmarrjes. Këto vonesa përkohësisht kanë ndikuar negativisht në likuiditetin e ndërmarrjes, të cilat përbëjnë një komponent të rëndësishëm të strukturës financiare.

Detyrimet ekzistuese kreditore:

Kredia 1 – BERZH, përfundon në vitin 2028

Kredia 2 – BERZH, përfundon në vitin 2034

Pagesat për të dy kreditë realizohen me dy këste për çdo gjashtëmuor, dhe kjo kërkon stabilitet në fluksin e të ardhurave mujore

- **Rreziku Operativ (Plani për vitin 2026)**

Një ndër rreziqet kryesore operative për ndërmarrjen në vitin 2026 lidhet me infrastrukturën ekzistuese rrugore dhe teknike, e cila në disa zona nuk është në përputhje me kërkesat për operim efikas të transportit publik. Kjo situatë mund të ndikojë negativisht në përmbushjen e indikatorëve të performancës, të përcaktuar në kontratën PSC (Public Service Contract) me komunën.

Ndikimi në ndërmarrje:

Indikatorët e performancës, si p.sh. saktësia në orare, mbulimi i itinerareve, frekuenca dhe kualiteti i shërbimit, janë drejtpërdrejt të lidhur me faturimin mujor “të hyrat nga bonusi” që i bëhet komunës. Nëse për shkak të infrastrukturës (rrugë të dëmtuara, mungesë sinjalistike, bllokime të trafikut, mungesë hapësirash për ndalesa, etj.) nuk arrihen këta indikatorë, atëherë rrezikohet zbritja (malusi) i kompensimit financiar mujor.

- **Strategjitë për Menaxhimin e Rreziqeve Kryesore në vitin 2026**

Identifikimi dhe menaxhimi efektiv i rreziqeve janë kyçe për të siguruar qëndrueshmërinë dhe suksesin afatgjatë të ndërmarrjes. Për rreziqet financiare dhe operative të përmendura më sipër, ndërmarrja ka planifikuar masa dhe strategji specifike për t’u përballur me to, duke pasur parasysh edhe kufizimet nga faktorët e jashtëm.

- Strategjitë për menaxhimin e rrezikut financiar mund të jetë një bashkëpunim i ngushtë me kompetent komunal për të siguruar transparencë dhe informim të hershëm mbi çdo vonesë të mundshme në pagesa.

- Planifikim dhe kontroll i kujdesshëm i rrjedhës së parasë (Cash Flow), duke krijuar rezervë financiare të dedikuar për pagesat e kësteve të kredisë, që siguron përballueshmëri edhe në rast vonesash.

- **Strategjitë për menaxhimin e rrezikut operacional nga infrastruktura:**

- Komunikim i vazhdueshëm me komunën dhe kompetentët e saj për infrastrukturën, me qëllim identifikimin dhe adresimin e pengesave rrugore dhe teknike që ndikojnë në performancën e shërbimit;

- Përgatitje dhe adaptim fleksibël i itinerareve dhe orareve të shërbimit, në përputhje me kushtet reale të infrastrukturës, për të minimizuar ndikimin në përmbushjen e indikatorëve të performancës;

- Raportim i çdo pengese apo problematike infrastrukturore, për t’i komunikuar komunës dhe për t’u përdorur si bazë në negociatat për modifikime të kushteve kontraktuale ose kompensime.

Bashkëpunimi me komunën është një aspekt kyç për “Trafiku Urban” për të arritur qëllimet e saj strategjike dhe për të ofruar shërbime të cilësisë së lartë për qytetarët e Prishtinës. Duke punuar

ngushtë me Departamentin e Shërbimeve Publike të Komunës së Prishtinës, "Trafiku Urban" do të jetë në gjendje të krijoj një sistem të qëndrueshëm dhe efikas të transportit publik, duke kontribuar kështu në zhvillimin e përgjithshëm të qytetit.

## 5. Marrëveshje Bashkëpunimi me Palët e Treta

Marrëveshjet me palët e treta janë një element i rëndësishëm për ndërmarrjen "Trafiku Urban". Këto marrëveshje mund të përfshijnë bashkëpunime me kompani të tjera, institucione financiare, ofrues të shërbimeve teknologjike, ose partnerë të tjerë strategjikë që ndihmojnë në përmirësimin e operacioneve dhe shërbimeve të ndërmarrjes.

- **Përfitimet kryesore të marrëveshjeve me palët e treta:**

- **Rritja e efikasitetit operativ:** Duke bashkëpunuar me institucione publike dhe kompani tjera që ofrojnë shërbime ose produkte të specializuara, ndërmarrja mund të përmirësojë efikasitetin e saj operativ dhe të optimizoj përdorimin e resurseve.

- **Mbështetje teknologjike dhe inovacion:** Partneritetet me ofrues të teknologjisë dhe inovacionit mund të ndihmojnë në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të flotës, të sigurisë, dhe të përvojës së udhëtimit për pasagjerët.

- **Përmirësimi i shërbimeve për qytetarët:** Përmes bashkëpunimeve me palë të ndryshme, ndërmarrja mund të zgjerojë gamën e shërbimeve dhe të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët e Prishtinës. Marrëveshjet me palët e treta janë një faktor kyç në ndërtimin e një baze të fortë operacionale dhe në zgjerimin e mundësive për rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm të ndërmarrjes "Trafiku Urban".

## 6. SWOT Analiza

### Forcat (Strengths):

Tarifa të përballueshme për qytetarët – Transport publik i qasshëm për të gjithë.

Përdorimi i teknologjisë për menaxhimin e orareve dhe linjave – Aplikacione dhe sisteme digjitale që rrisin efikasitetin.

**Kontratë për Shërbime Publike (PSC)** – Siguron të ardhura të qëndrueshme për operimin.

Zhvillim i marketingut – Nënshkrimi i kontratës për reklamim në autobusë ka krijuar burim të ri të ardhurave.

S

**Mundësitë (Opportunities)** Blerja e 30 autobusëve të rinj – Procesi është në fazën përfundimtare, çka do të përmirësojë cilësinë dhe frekuencën e shërbimit

Implementimi i softuerit të menaxhimit (2026) – Do të digjitalizojë proceset e brendshme dhe do të rrisë efikasitetin operacional.

Rritje të të ardhurave nga marketingu – Reklama në autobusë dhe brendimi do të sjellin të ardhura shtesë dhe rritje të vizibilitetit.

Përmirësimi i kushteve të punës për punonjësit – Mundësi për rritje të pagave dhe zhvillim profesional.

Rritja e ndërgjegjësimit për transportin publik si zgjidhje ekologjike – Tendencë globale për më shumë përdorim të transportit publik.

O

### Dobësitë (Weaknesses):

**Amortizimi i flotës ekzistuese** – Shumica e autobusëve aktualë janë blerë në vitin 2017 dhe janë në përdorim intensiv për shkak të frekuentimit të lartë nga qytetarët. Kjo ka shkaktuar amortizim të përshpejtuar të mjeteve, duke rritur kostot për mirëmbajtje.

**Mungesa e korsive të dedikuara për autobusë** – Mund të sjell vonesa në linja dhe zvogëlon duke ndikuar në indikatorët e performancës sipas PSC.

**Vështirësi në menaxhimin e mirëmbajtjes** – Mungesa e autobusëve rezervë shkakton ndërprerje.

W

### Kërcënimet (Threats):

**Rritje e kostove të mirëmbajtjes për flotën aktuale** – Deri në zëvendësimin e plotë me mjete të reja, kostot mbesin të larta.

**Largimi i stafit të kualifikuar, sidomos shoferëve** – Mundësi më të mira punësimi jashtë vendit rrezikojnë stabilitetin e operativës.

**Aksidentet në komunikacion** – Mund të shkaktojnë ndërprerje të shërbimeve dhe kosto të larta për riparime ose zëvendësime.

**Mungesa e mbështetjes infrastrukturore nga komuna** – Nëse nuk krijohen korsitë të dedikuara apo përmirësimi i infrastrukturës, efikasiteti i shërbimit do të mbetet i kufizuar.

T




## 7. Administrata

Administrata në ndërmarrjen "Trafiku Urban" ka një rol thelbësor në mbështetje të funksionimit të brendshëm dhe mbështetjen e të gjitha njësive tjera të ndërmarrjes, duke u siguruar që ndërmarrja të ketë një menaxhim efikas dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

Objektivi kryesor i saj është ndërtimi i një strukture administrative moderne dhe funksionale, që siguron rritje të efikasitetit të brendshëm, zhvillim të kapaciteteve të stafit dhe zbatim të politikave transparente e të qëndrueshme në përputhje me standardet ligjore dhe praktikatat më të mira të menaxhimit publik, me qëllim që të rritet produktiviteti dhe cilësia e shërbimeve.

### 7.1 Burimet Njerëzore

Burimet njerëzore përben një nga shtyllat kryesore të funksionimit organizativ në ndërmarrje, pasi që administron dhe zhvillon kapitalin njerëzor si resursin më të çmuar të institucionit. Kjo zyre ka mandat ligjor, transparent dhe efikas të marrëdhënieve të punës duke kontribuar drejtpërdrejtë në arritjen e objektivave strategjike të ndërmarrjes. Prandaj, menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore është një prioritet kyç për sigurimin e efikasitetit organizativ.



Figurë 1. Sistemi i organizimit në Burime Njerëzore

- **Administrimi i kontratave të punës:**
  - Zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme që rregullojnë marrëdhënien e punës.
  - Hartimi, monitorimi dhe arkivimi i kontratave të punës.
  - Respektimi i të drejtave dhe detyrimeve ligjore të punëtorëve.
  
- **Rekrutimi dhe përzgjedhja e stafit:**
  - Në bazë të kërkesave të parashtruara nga drejtoritë përkatëse të ndërmarrjes, planifikohet hapja e procedurave të rekrutimit për plotësimin e vendeve të punës, në përputhje me organogramin dhe rregulloren për sistematizimin e pozitave brenda ndërmarrjes.
  - Do të zbatohet një proces i qartë dhe transparent për rekrutimin e stafit, duke u mbështetur në kritere meritokracie, përvojë profesionale dhe përputhje me vlerat e ndërmarrjes. Qëllimi është të sigurohet angazhimi i individëve me kompetenca të larta dhe etikë të lartë profesionale.
  
- **Zhvillimi profesional dhe trajnimi i vazhdueshëm:**
  - NPK “Trafiku Urban” SHA do të investojë në ndërtimin e kapaciteteve të brendshme përmes trajnimeve periodike, si në aspektin teknik ashtu edhe në zhvillimin e aftësive ndër personale dhe menaxheriale. Trajnimet do të jenë të orientuara drejt përmirësimit të cilësisë së shërbimit dhe rritjes së sigurisë në transportin urban.
  - Në koordinim me drejtorët e drejtorive, menaxherët, do të hartohen lista të temave prioritare për trajnim, në përputhje me nevojat aktuale dhe zhvillimet në sektor, duke pasur si synim rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e performancës së punonjësve të ndërmarrjes.
  
- **Vlerësimi i performancës dhe menaxhimi i karrierës:**
  - Zbatimi i një mekanizmi të qëndrueshëm dhe të standardizuar për vlerësimin e performancës së punonjësve, i cili synon identifikimin e kompetencave kyçe, mangësive potenciale dhe mundësive për zhvillim individual. Ky proces do të shërbejë si një instrument strategjik për ndërtimin e planeve të personalizuara të zhvillimit profesional dhe për forcimin e kapaciteteve organizative në tërësi.
  - Krijimi dhe fuqizimi i një mjedisi pune që nxit dialog të hapur dhe feedback konstruktiv ndërmjet menaxhmentit dhe stafit, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave të punës, rritjen e transparencës dhe konsolidimin e një kulture organizative të bazuar në besim, respekt të ndërsjellë dhe përfshirje aktive.



Foto 1. Organizimi i trajnimeve.

- **Menaxhimi i Burimeve Njerëzore**

Burimet njerëzore është mekanizmi kyç për menaxhimin e fuqisë punëtore në ndërmarrje, përbën një komponent kyç në funksionimin efikas dhe të qëndrueshëm të çdo ndërmarrjeje. Përmes investimeve të qëndrueshme në rekrutim, zhvillim profesional, motivim dhe menaxhim të performancës, krijohet një fuqi punëtore e aftë, e angazhuar dhe e përkushtuar ndaj objektivave strategjike të ndërmarrjes. Një qasje e tillë jo vetëm që kontribuon në arritjen e synimeve afatgjata të ndërmarrjes, por edhe garanton ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme.

Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe procedurave të qarta në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore është thelbësor për të siguruar përputhshmëri me kornizën ligjore, standardet etike dhe strukturën organizative. Në këtë kontekst, analizimi i vazhdueshëm i mjedisit të brendshëm të punës dhe përshtatja me dinamikën në ndryshim të tregut të punës përbën bazën për përmirësimin e proceseve ekzistuese.

Përdorimi strategjik i teknologjisë moderne në menaxhimin e burimeve njerëzore luan një rol thelbësor në rritjen e efikasitetit operacional dhe në garantimin e transparencës përgjatë të gjithë zinxhirit të menaxhimit të kapitalit njerëzor. Kjo qasje e integruar ndihmon në ndërtimin e një ndërmarrjeje më fleksibile, konkurruese dhe të orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

## 7.2 Zyra Ligjore

Zyra Ligjore në NPK “Trafiku Urban” SHA, si njësi e brendshme funksionale e ndërmarrjes, luan rol parësor dhe të domosdoshëm në garantimin e ligjshmërisë, mbrojtjen e interesave juridike të ndërmarrjes dhe sigurimin e përputhshmërisë së veprimtarisë institucionale në përputhje me aktet e brendshme dhe legjislacionin në fuqi.

Në këtë aspekt, hartimi dhe zbatimi i një plani të strukturuar dhe gjithëpërfshirës për menaxhimin e funksioneve të Zyrës Ligjore është imperativ për sigurimin e ligjshmërisë institucionale në të gjitha nivelet vendimmarrëse.

Ky plan parashikon iniciativë strategjike që synojnë forcimin e kapaciteteve ligjore të ndërmarrjes, përmirësimin e proceseve të këshillimit juridik, harmonizimin e praktikave të brendshme me legjislacionin përkatës, si dhe garantimin e një administrimi efikas dhe të qëndrueshëm të çështjeve juridike. Përmes kësaj qasjeje, Zyra Ligjore do të funksionojë si një mekanizëm mbështetës proaktiv, duke kontribuar në parandalimin e riskut ligjor dhe në mbrojtjen efektive të interesit publik të ndërmarrjes.

- **Menaxhimi i Kontratave dhe Marrëveshjeve:**

- **Sistemi i Menaxhimit të Kontratave:** Krijimi dhe operacionalizimi i një sistemi të integruar elektronik për menaxhimin e kontratave, i cili do të shërbejë si një databazë qendrore për arkivimin, klasifikimin dhe aksesimin e të gjitha marrëveshjeve kontraktuale të lidhura me palë të treta. Ky sistem do të mundësojë transparencë të

plotë të kontratave, nga momenti i negocimit deri në përfundimin apo amadamentimin e tyre.

- **Monitorimi i Afateve dhe Detyrimeve Kontraktuale:** Zbatimi i një mekanizmi të automatizuar për mbikëqytjen e afateve të vlefshmërisë, kushteve ekzekutive dhe detyrimeve thelbësore të përfshira në kontrata, me qëllim sigurimin e përmbushjes së obligimeve në përputhje me termat kontraktualë dhe shmangien e vonesave, penaliteteve apo shkeljeve të mundshme të dispozitave ligjore dhe kontraktuale.

- **Këshillimi Ligjor:**

- **Dhënia e Opinioneve Ligjore:** Ofrimi i opinioneve ligjore të specializuar për strukturat drejtuese dhe njësitë funksionale të ndërmarrjes, në lidhje me vendimmarrjen strategjike, hartimin dhe zbatimin e procedurave të brendshme, si dhe formulimin e politikave institucionale, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë së plotë me legjislacionin në fuqi.
- **Konsultimi mbi Aktet e Brendshme të Ndërmarrjes:** Garantimi i harmonizimit të veprimtarisë së ndërmarrjes me legjislacionin dhe aktet nënligjore përkatëse, përmes ofrimit të udhëzimeve juridike dhe interpretimit të saktë të dispozitave ligjore dhe akteve të brendshme të cilat ndikojnë në funksionimin organizativ të ndërmarrjes.

- **Menaxhimi i Ankesave dhe Procedurave Ligjore:**

- **Administrimi i Ankesave dhe Çështjeve Juridike:** Hartimi dhe implementimi i një procedure të standardizuar për administrimin e ankesave dhe trajtimin e çështjeve me natyrë juridike, me synim garantimin e një procesi transparent, të drejtë dhe efikas. Kjo përfshin evidentimin, klasifikimin, shqyrtimin dhe zgjidhjen e çdo rasti në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe të drejtës procedurale.
- **Përfaqësimi dhe Mbrojtja Juridike e Ndërmarrjes:** Hartimi i dokumentacionit përkatës ligjor dhe përgatitja profesionale për përfaqësimin e ndërmarrjes “Trafiku Urban” përpara gjykatave, institucioneve administrative apo organeve të tjera kompetente, me qëllim mbrojtjen efektive të interesave të saj ligjore dhe institucionale në të gjitha fazat e procedurave.

- **Përmirësimi i Procedurave të Brendshme:**

- **Hartimi dhe Rishikimi i Politikave Institucionale:** Zhvillimi, standardizimi dhe përditësimi periodik i politikave dhe procedurave të brendshme me qëllim garantimin e përputhshmërisë së plotë me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe rritjen e efikasitetit operacional dhe të qartësisë procedurale në veprimtarinë e ndërmarrjes.
- **Administrimi i Dokumentacionit Juridik:** Vendosja e një metodologjie të strukturuar për menaxhimin, arkivimin dhe ruajtjen e dokumentacionit juridik,

përfshirë udhëzime të detajuara për klasifikimin, qasjen dhe mbrojtjen e të dhënave, me synim garantimin e integritetit, konfidencialitetit ndaj informacionit ligjor.

- **Monitorimi dhe Raportimi:**

- **Vlerësimi i Performancës Juridike:** Zhvillimi dhe zbatimi i mekanizmave të strukturuar për monitorimin e performancës së Zyrës Ligjore, me qëllim garantimin e ofrimit të shërbimeve juridike në mënyrë profesionale, të qëndrueshme dhe në kohë. Ky proces përfshin analiza të rregullta të efikasitetit në trajtimin e çështjeve ligjore, respektimin e afateve dhe cilësinë e këshillimit të dhënë.
- **Raportimi Strategjik dhe Periodik:** Hartimi dhe dorëzimi i raporteve periodike ndaj menaxhmentit të lartë mbi aktivitetin juridik të ndërmarrjes, përfshirë analizën e përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi, përparimin e çështjeve të hapura ligjore, si dhe rekomandimet për përmirësim. Këto raporte do të shërbejnë si bazë për vendimmarrje të informuar dhe për forcimin e qeverisjes së brendshme.

- **Menaxhimi i Zyrës Ligjore:**

Plani strategjik për Zyrën Ligjore të Ndërmarrjes “Trafiku Urban” synon fuqizimin e rolit të saj në garantimin e përputhshmërisë ligjore dhe në rritjen e efikasitetit institucional. Përmes zbatimit të këtyre iniciativave, Zyra Ligjore do të funksionojë si një strukturë mbështetëse thelbësore në realizimin e objektivave të ndërmarrjes, duke ofruar këshillim juridik cilësor, duke menaxhuar në mënyrë efektive risqet ligjore dhe duke siguruar mbrojtjen proaktive të interesave të saj ligjore e kontraktuale.

Kjo qasje gjithëpërfshirëse do të kontribuojë në ndërtimin e një ambienti institucional më të qëndrueshëm, të sigurt dhe të organizuar, duke përforcuar funksionimin e përditshëm të ndërmarrjes në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe qeverisjes së mirë.

### 7.3 Teknologjia Informative

Zyra e Teknologjisë Informative luan një rol kyç në funksionimin efikas dhe modern të ndërmarrjes. Si një njësi mbështetëse dhe strategjike, kjo zyrë është përgjegjëse për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e infrastrukturës digjitale, e cila përbën bazën për ofrimin e shërbimeve publike në mënyrë të integruar, transparente dhe të qëndrueshme.

- **Menaxhimi i Infrastrukturës IT:** Mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e rrjeteve kompjuterike, serverëve, pajisjeve elektronike dhe sistemeve të komunikimit brenda ndërmarrjes.
- **Zhvillimi dhe Integrimi i Sistemeve Digjitale:** Implementimi i platformave digjitale për menaxhimin e të dhënave, automatizimin e proceseve administrative dhe operacionale, si dhe krijimi i sistemeve për raportim dhe analizë.

- **Siguria Kibernetike:** Zbatimi i politikave dhe masave për mbrojtjen e të dhënave, parandalimin e sulmeve kibernetike dhe garantimin e privatësisë së informacionit të brendshëm dhe të qytetarëve.
- **Mbështetja Teknike për Stafin:** Ofrimi i asistencës teknike për të gjithë departamentet, duke siguruar që të gjitha sistemet funksionojnë pa ndërprerje dhe në përputhje me kërkesat e punës.
- **Planifikimi Strategjik Teknologjik:** Hartimi i strategjive afatgjata për zhvillimin teknologjik të ndërmarrjes, në përputhje me objektivat organizative dhe transformimin digjital.
- **Menaxhimi i Zyrës për Teknologji Informativ:**
  - Rrit efikasitetin dhe produktivitetin në kryerjen e detyrave ditore.
  - Lehtëson qasjen në të dhëna dhe vendimmarrjen e bazuar në evidencë.
  - Përmirëson transparencën dhe llogaridhënien.
  - Mbështet transformimin digjital dhe modernizimin e shërbimeve.

## Kuleta Digjitale e Prishtinës




Foto 2. Mënyra e pagesës përmes biletës digjitale

## 7.4 Plani i Marketingut

Plani i marketingut synon të rrisë përdorimin e shërbimeve të transportit publik, si dhe të përmirësojë imazhin e ndërmarrjes në mesin e qytetarëve të Prishtinës. Ky plan do të përfshijë strategji dhe aktivitete të ndryshme për të arritur këto qëllime, duke përfshirë komunikimin efektiv, promovimin e shërbimeve dhe angazhimin me komunitetin.

- **Analiza e Tregut**

Hulumtimi i tregut, identifikimi i nevojave dhe preferencave të përdoruesve të shërbimeve të transportit publik në Prishtinë.

- **Strategjitë e Marketingut**

Krijimi i një imazhi të qartë për "Trafiku Urban" si një shërbim të besueshëm, efikas dhe të përkushtuar ndaj udhëtarëve.

Formulimi i mesazheve kyçe që theksojnë përfitimet e përdorimit të transportit publik, si reduktimi i ndotjes dhe lehtësimi i trafikut.

- **Monitorimi dhe Vlerësimi**

Përdorimi i mjeteve për të monitoruar efektivitetin e fushatave dhe strategjive të marketingut, duke përcaktuar treguesit kryesorë të performancës.

Plani i marketingut për "Trafiku Urban" do të ndihmojë në rritjen e përdorimit të shërbimeve të transportit publik dhe përmirësimin e imazhit të ndërmarrjes. Duke zbatuar këto strategji dhe aktivitete, Ndërmarrja do të jetë në gjendje të komunikoj më mirë me qytetarët, të kontribuojë në zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të transportit publik në Prishtinë.

## 7.5 Marketing komercial

Ne po përpiqemi të jemi në trend me zhvillimet e fundit dhe kemi filluar procesin e brendimit të autobusëve tanë në përputhje me standardet ndërkombëtare të përdorura në vendet e ndryshme të botës.



Foto 3. Brendimi i jashtëm i autobusëve

Qëllimi i këtij projekti është ofrimi i mundësisë për brendimin e autobusëve të Trafikut Urban në pjesën e jashtme dhe të brendshme si dhe vendosjen e monitorëve reklamues/informues brenda tyre. Kështu, Trafiku Urban do të mund të gjeneroj të ardhura shtesë nga qiraja e tyre dhe të përdor hapësirat reklamuese/informuese edhe për nevoja të komunës në raste të ndryshme.



Foto 4. Vendosja e monitorëve në autobusë.



- **Përfshirja e linjave të transportit brenda platformës Google Maps**

Linjat e transportit publik të Prishtinës janë përfshirë në Google Maps.

Pra qytetarët mund të kenë informata të sakta për linjat e “Trafiku Urban” dhe për mënyrën e arritjes sa më të shpejte në stacionin më të afërt dhe destinacionin e kërkuar.




Foto 5. Përfshirja e linjave të transportit brenda platformës Google Maps.

- **Komunikatat për shtyp**

Komunikatat për shtyp dhe shpalljet për ndryshimet e përkohshme apo të përhershme lidhur me Shërbimet e Transportit Publik Lokal, realizohen përmes:

- Ueb faqes: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com)
- Email-it zyrtar: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com)
- Rrjeteve sociale, Facebook, Instagram etj.



- Shpërndarja e informacioneve për çmimin e biletave dhe metodat e pagesës:

- Llojin e biletave.
- Çmimin e biletave.

Biletë për një drejtim 0.50€	Bileta Ditore 0.80€	Biletë javore 4€	Bileta mujore 13.50€
Bileta për një drejtim, brenda territorit të Prishtinës.	Bileta Ditore përfshin udhëtime vajtje-ardhje pa limit. Përdoret për të gjitha linjat e Komunës së Prishtinës.	Bileta Ditore përfshin udhëtime vajtje-ardhje pa limit. Përdoret për të gjitha linjat e Komunës së Prishtinës.	<b>Bileta mujore e integruar</b> për nxënës ose student kushton 12.00 Euro. Për qytetarët tjerë është 13.50€/muaj. Përdoret për të gjitha linjat e TU-së.  <b>Bileta mujore e linjës</b> për nxënës ose student kushton 10.00 Euro. Për qytetarët tjerë është 12€/muaj. Përdoret për një linjë të caktuar.

### Pikat e shitjes



#### 1. Kioska prapa Objektivit të Komunës (Tek “Plepat”),.

Orari i punës: E hënë - E shtune 07:00- 21:00  
E diele: 08:00-16:00

#### 2. Kioska në lagjen “Kodra e Diellit”, tek “Banesat e Bardha”,

Orari i punës: E hënë - E premte 07:00- 21:00  
E shtune: 07:00-14:00

#### 3. Kioska në Bulevardin “Bill Kllinton” afër nënkalimit.

Orari i punës: E hënë - E shtune 07:00- 21:00  
E diele: 08:00-16:00

## 8. Transporti

Njësia e transportit është përgjegjës për planifikimin, menaxhimin dhe realizimin e shërbimeve të transportit publik. Detyra kryesore e tij është të garantojë operim të sigurt dhe të besueshëm në të gjitha linjat e ndërmarrjes, duke optimizuar oraret dhe rregullat e qarkullimit. Nëpërmjet analizave të vazhdueshme të kërkesës dhe vlerësimit të performancës, synohet përmirësimi i përvojës së udhëtarëve dhe rritja e përdorimit të shërbimit.

Transporti si njësi për vitin 2026 ka përgatitur plan të detajuar të operimit vjetor të autobusëve në linjat ku Trafiku Urban operon sipas vendimit nga Komuna e Prishtinës. Detajet e planit janë: Itinerari i qarkullimit të autobusëve në linja, rendi i udhëtimit si dhe kilometrat e planifikuara për operim duke ju përshtatur rregullave të kontratës PSC.

### Përshkrim i rrethave të udhëtimit si dhe koha e qarkullimit në linjat e TU-së


- Linja nr. 1, Prishtinë - Fushë Kosovë dhe anasjelltas.  
 - Operon me 9 (nëntë) autobus, çdo ditë nga ora 06:00 - 24:00.




- Linja nr. 1A, Prishtinë - Aeroport dhe anasjelltas.  
 - Operon me 1 (një) autobus, çdo ditë nga ora 07:00 - 24:00.




- Linja nr. 3, Rrethi i Matit – fshati Bardhosh dhe anasjelltas.  
- Operon me 10 (dhjetë) autobus, çdo ditë nga ora 06:00 - 24:00.



- Linja nr. 3B, Rrethi i Matit – fshati Bërnice e Ulët, është pjesë e linjës 3.  
- Operon me 2 (dy) autobus, çdo ditë nga ora 07:00 - 19:00.




- Linja nr. 3C, Bregu i Diellit – fshati Sinidoll dhe anasjelltas.  
- Operon me 6 (gjashtë) autobus, çdo ditë nga ora 06:00 - 22:00.



- Linja nr. 4, Lagja Mat - Parku i Gërmisë dhe anasjelltas.  
- Operon me 18 (tetëmbëdhjetë) autobus, çdo ditë nga ora 06:00 - 24:00.



- Linja nr. 7C, Kalabri - Qendër dhe anasjelltas.  
- Operon me 4 (katër) autobus, çdo ditë nga ora 06:00 - 22:00.



- Linja nr. 15, Prishtinë - fshati Prapashticë dhe anasjelltas.  
- Operon me 1 (një) autobus, çdo ditë nga ora 07:00 - 19:00.



- Linja nr. 19, Prishtinë - Kishnicë dhe anasjelltas.  
- Operon me 1 (një) autobus, çdo ditë nga ora 07:00 - 19:00.



## 9. Mirëmbajtja

Mirëmbajtja si njësi në ndërmarrjen "Trafiku Urban" ka një rol të rëndësishëm në sigurimin e operimit të sigurt dhe efikas të flotës së autobusëve. Plani i mirëmbajtjes është i ndërtuar për të maksimizuar performancën e mjeteve dhe për të minimizuar kohën e mos operimit. Kjo ndihmon në ofrimin e shërbimeve cilësore për pasagjerët dhe në optimizimin e kostove operacionale. Më poshtë janë disa elemente kryesore të planifikimit të mirëmbajtjes:

- **Strategjia e Mirëmbajtjes**

- **Mirëmbajtja e Rregullt:** Përcaktimi i një programi të rregullt të kontrollit dhe mirëmbajtjes për çdo autobus në flotë, përfshirë kontrollin e motorit, sistemin e frenave, dhe komponentëve tjerë kritikë.
- **Mirëmbajtja Parandaluese:** Zbatimi i procedurave për identifikimin e problemeve potenciale përpara se ato të shndërrohen në defekte të rënda, duke përfshirë inspektime të rregullta dhe analiza të performancës.

- **Planifikimi i Burimeve**

- **Stafi i Kualifikuar:** Angazhimi dhe trajnimi i stafit të mirëmbajtjes për të siguruar që ata kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kryer punët e mirëmbajtjes në mënyrë efektive.
- **Pjesët Rezervë:** Menaxhimi i depozitave të pjesëve rezervë për të siguruar disponueshmërinë e shpejtë të komponentëve të nevojshëm për riparime dhe mirëmbajtje.

- **Monitorimi dhe Vlerësimi**

- **Sistemi i Menaxhimit të Flotës:** Përdorimi i teknologjisë për monitorimin e performancës së mjeteve dhe për regjistrimin e historikut të mirëmbajtjes, për të siguruar një qasje të bazuar në të dhëna për vendimmarrje.

- **Analiza e Performancës:** Vlerësimi i performancës së sektorit të mirëmbajtjes përmes analizave të koston dhe efikasitetit, për të identifikuar mundësi për përmirësim.


- **Siguria dhe Cilësia**

- **Standarde të Larta të Sigurisë:** Përcaktimi i standardeve të larta të sigurisë për proceset e mirëmbajtjes, për të garantuar që çdo autobus është në gjendje të sigurt për të transportuar udhëtarët.
- **Kontrolli i Cilësisë:** Zbatimi i procedurave për të siguruar që të gjitha punimet e mirëmbajtjes përmbushin standardet e cilësisë dhe sigurisë.

Planifikimi në mirëmbajtje është i një rëndësie të veçantë për suksesin e "Trafiku Urban". Një qasje strategjike dhe e sistemuar do të ndihmojë në garantimin e një flote të sigurt dhe efikase, duke përmirësuar përvojën e udhëtarëve dhe duke rritur qëndrueshmërinë e operacioneve të transportit publik në Prishtinë.

- **Rritja e të hyrave**

Sektori i Mirëmbajtjes, si një ndër sektorët kyç që garanton sigurinë financiare të ndërmarrjes, planifikon që gjatë vitit 2026 të zgjerojë gamën e shërbimeve, duke reduktuar më tej shpenzimet operative dhe njëkohësisht të shndërrohet në një njësi gjeneruese të të ardhurave, përmes ofritit të shërbimeve për palë të treta.



Figurë 2. - Grafik që paraqet rritjen e të hyrave nga palët e treta

Për arritjen e këtij qëllimi, parashihen të realizohen disa investime strategjike, ndër to:

- Makinë për riparimin e injektorëve të naftës;
- Makinë për riparimin e turbinave;
- Makinë për rrafshimin e kokës së motorit;
- Makinë për pastrimin e pjesëve të karbonizuara;
- Makinë për pastrimin e filterëve të sistemit të emetimit të gazrave;
- Frezë NC;
- Makinë automatike për larjen e jashtme të autobusëve dhe kamionëve.



*Foto 6. Sistem i kontrollës teknike që synohet të investohet në Trafikun Urban*

Në të njëjtën linjë zhvillimore, përmirësimi i kushteve të punës dhe avancimi i metodave të punës në Mirëmbajtje paraqet një tjetër prioritet të rëndësishëm për vitin 2026. Kjo do të realizohet përmes investimeve kapitale, si:

- rikonstruktimi i kanaleve të punës;
- funksionalizimi i njësisë së gomsterisë përmes blerjes së pajisjeve për montim dhe balancim të gomave;
- ndërtimi i dhomës së riparimeve gjenerale të motorëve dhe ndërruesve;
- shtrirja e rrjetit pneumatik në hapësirat punuese.

Këto investime do t'i mundësojnë ndërmarrjes të shfrytëzoj stafin profesional ekzistues, të rrisë efikasitetin operativ dhe të gjeneroj të hyra financiare shtesë, duke e pozicionuar Sektorin e Mirëmbajtjes si një hallkë të rëndësishme në zhvillimin e qëndrueshëm të ndërmarrjes.

Po ashtu, ridizajnimi i parkingut të autobusëve sipas standardeve mbetet domosdoshmëri për shkak të sigurisë dhe rritjes së numrit të autobusëve në 81. Më poshtë do e paraqesim me foto si planifikohet të duket organizimi i parkingut brenda hapësirave të ndërmarjes.



Foto 7. Formë e mundshme e organizimit të autoparkut

- Pamja dhe imazhi i objektit të ndërmarrjes Trafiku Urban

Pamja e objektit të ndërmarrjes "Trafiku Urban" është një faktor i rëndësishëm për krijimin e një imazhi pozitiv. Një ambient i mirë organizuar dhe estetik jo vetëm që rrit besimin e përdoruesve në shërbimet e ofruara, por gjithashtu kontribuon në një ndjesi të përgjithshme të mirëqenies në transportin publik. Plani për renovimin e kioskës në hyrje të objektit përfaqëson një hap strategjik në drejtim të përmirësimit të dukjes dhe funksionalitetit të këtij ambienti, duke ofruar mundësi për shërbime më të mira dhe për një përvojë më të këndshme për qytetarët. Më poshtë po e ilustruam me foto si do të duket hapësira e jashtme e ndërmarrjes.



*Foto 8. Pamje e hapësirës së jashtme*



*Foto 9. Pamje e kioskës*

## 9.1 Shërbimet Mbështetëse

Shërbimet Mbështetëse kujdesen për pastrimin e autobusëve, mirëmbajtjen e ambienteve të punës dhe shërbimeve logjistike.

Të gjitha njësitë e sektorëve të ndërmarrjes bashkëpunojnë ngushtë për të siguruar që “Trafiku Urban” të ofrojë shërbime cilësore dhe efikase për qytetarët e Prishtinës. Komunikimi dhe koordinimi ndërmjet tyre janë thelbësore për realizimin e qëllimeve strategjike dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve të udhëtarëve në transportin publik.

Si synim zhvillimi i Shërbimeve Mbështetëse parasheh blerjen e makinës automatike për larjen e jashtme të autobusëve.

Qëllimi i këtij projekti është ngritja e kapaciteteve në autolarje me makinë industriale, e cila do të mundësoj ngritjen e efikasitetit në larjen e autobusëve. Gjithashtu do të përmirësohen kushtet e punës për punëtorët e autolarjes dhe do të mundësoj ofrimin e shërbimeve për palët e treta dhe inkasimin e mjeteve financiare nga pastrimi i autobusëve dhe kamionëve privat.



*Foto 10. - Sistem i larjes automatike të autobusëve*

## 10. Përfundim

Në Planin e Biznesit për vitin 2026 i NKL “Trafiku Urban” Sh.A. paraqet drejtimin strategjik të ndërmarrjes për zhvillim të qëndrueshëm, rritje të efikasitetit dhe përmirësim të cilësisë së shërbimeve publike të transportit në qytetin e Prishtinës. Gjatë këtij viti, ndërmarrja synon të fokusohet në:

- Optimizimin e flotës ekzistuese përmes mirëmbajtjes së rregullt dhe menaxhimit të kujdesshëm të resurseve teknike dhe njerëzore;
- Zbatimin e masave për përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve, me theks në respektimin e orareve, pastërtinë dhe sigurinë në transport;
- Përmirësimin e sistemit të të hyrave përmes biletimit digjital, kontrollit më të mirë të qarkullimit të biletave dhe bashkëpunimeve me palë të treta;
- Menaxhimin racional të shpenzimeve operative, për të siguruar stabilitet financiar dhe transparencë në përdorimin e mjeteve publike;
- Zbatimin e politikave mjedisore, me synim uljen e ndotjes dhe promovimin e transportit të gjelbër dhe energjisë së pastër.

Përmes këtij plani, NKL “Trafiku Urban” Sh.A. Prishtinë riafirmon angazhimin e saj për të qenë një ndërmarrje moderne, efikase dhe në shërbim të qytetarëve, duke kontribuar në zhvillimin e mobilitetit të qëndrueshëm dhe cilësisë së jetës në kryeqytet.

Zbatimi i suksesshëm i këtij plani do të sigurojë bazën për rritje të mëtejshme institucionale dhe përgatitjen për zgjerime të reja gjatë viteve në vijim.

## Aneksi 1 Plani i Buxhetit për vitin 2026

PLANI I BIZNESIT PER VITIN 2026		NPK TRAFIKU URBAN SHA
PLANIFIKIMI I TE HYRAVE		në Euro (€)
Të Hyrat nga kontrata PSC		15,135,567.00
Të hyrat tjera		65,000.00
Të hyra nga bonusi sipas PSC		200,000.00
Të Hyrat nga Marketingu		500,000.00
Të Hyrat sipas Kontrates ne shtepi		209,900.00
<b>TOTALI I TE HYRAVE</b>		<b>16,110,467.00</b>
PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE		në Euro (€)
Derivate		3,174,118.00
Shpenzime Komunale		55,000.00
Shpenzime të telefonis dhe internetit		20,000.00
Detyrime ndaj ATK-së sipas marrëveshjes		72,000.00
Shpenzime Financiare (BERZH)		250,500.00
Vajra, Ad Blue dhe Fluidet		213,480.00
Teknologji Informatike		147,200.00
Arka Fiskale		14,971.25
Shpenzime Operative		1,052,400.00
Administrative		30,840.00
Pagat		6,000,000.00
Shpenzime për Regjistrimin e Autobusëve dhe veturave zyrtare, GPS, pajisje komunikuese dhe shenjezim		105,000.00
Kontrollë sistematike për punëtorë		36,000.00
Shpenzime për Sigurim Shendetesor dhe Kontrollë sistematike		200,000.00
Shpenzime për matje të kënaqshmërisë së konsumatorëve		4,000.00
Shpenzime gjyqësore dhe konsulencë ligjore		218,500.00
Shpenzime te paparashikuara		10,000.00
Reprezentacion dhe Trajnime		58,900.00
Mirembajtje Objekti SSHM		100,000.00
Uniforma të punetoreve		30,000.00
Auditimi i Jashtem		9,500.00
Shpenzime te publikimit		7,000.00
Marreveshjet (PSC)		18,000.00
Ujë I ambalazhuar		12,000.00
Mbrojtje ne pune, lendime te punetoreve si dhe ndihme me rastin e vdekjeve sipas rregullores		10,000.00
Posta e shpejte		250.00
Shpenzime të humbjeve, dëmtimeve dhe mjeteve metalike false		5,000.00
<b>TOTAL</b>		<b>11,854,659.25</b>
<b>SHPENZIMET FIKSE/Tjera</b>		
<b>Totali i Shpenzimeve</b>		<b>11,854,659.25</b>
<b>Fitimi operativ para zhvleresimit</b>		<b>4,255,807.75</b>
<b>Shpenzimet e Zhvleresimit</b>		<b>1,900,000.00</b>
<b>Fitimi / Humbja Neto</b>		<b>2,355,807.75</b>
<b>KAPITALE</b>		<b>630,000.00</b>
<b>Fitimi / Humbja Neto</b>		<b>1,725,807.75</b>
<b>Detyrimi ndaj kredisë, principalit</b>		<b>1,600,000.00</b>
<b>Fitimi / Humbja Neto</b>		<b>125,807.75</b>

### Investimet Kapitale për vitin 2026

INVESTIMET KAPITALE PER VITIN 2026	
Makina industriale per larje te autobuseve, plani i fizibilitetit, trajnimi	138,500.00
Makinë për pastrimin e Particle Filter	20,000.00
Pirunjer per nevoja te ngarkim shkarkimit 3.5t	19,880.00
Inventarizimi i depos	15,000.00
Vinc port. per demontimin e nderr. Dhe motor. X2	7,000.00
Vinc per autobuse per kanale x 2 + 1 vinc per automjete 4.5t	28,000.00
Paisje salduese TIG dhe set i cilindrave se bashku me dizat per saldim dhe prerje	15,000.00
Inventarizimi dhe suvatimi i hapësirave të Autongjyrosjes, Dhomës së Mekanikëve + klimatizimi	4,500.00
Makinë për balancimin e gomave të autobusëve	12,000.00
Kompletimi i dhomes per riparime gjenerale	22,500.00
Makinë për rrafshimin e kokës së motorit	15,000.00
Makinë për riparimin e injektorëve	25,000.00
Makinë për riparimin e turbinave	17,500.00
Paisje diagnostifikuese OBD	8,000.00
Arka Fiskale	15,000.00
Kasafortë për arkë	1,200.00
Panela Solare	100,000.00
Eltrac Easy Eci for Iveco Truck Euro 6 Diagnostic Tool	8,000.00
Kompresor industrial me shtrirje te ajrit	25,000.00
Inventar	132,920.00
<b>TOTAL</b>	<b>630,000.00</b>

Në varësi të mundësive buxhetore, të cilat do të përcaktohen në vazhdimësi, gjatë vitit 2026 planifikohet edhe rifreskimi i flotës ekzistuese me 10-12 autobusë. Ky investim do të realizohet vetëm nëse sigurohen mundësitë e nevojshme financiare.

INVESTIMET KAPITALE PER VITIN 2026	
Ripërtrirja e Flotës së Autobusëve	1,000,000.00

VIJAT BUXHETORE ME SHPENZIME TË FUZIONUARA			Totali
		PLANIFIKIM 2026	
Shpenzime të derivateve	Shpenzimet e derivateve	€ 3,174,118.00	€ 3,174,118.00
Shpenzime komunale	Shpenzimet e rrymës	€ 48,000.00	€ 55,000.00
	Shpenzimet e ujit	€ 1,440.00	
	Shpenzimet për mbeturina	€ 5,560.00	
Shpenzime të telefonisë dhe internetit	Shpenzime të telefonisë mobile	€ 8,000.00	€ 20,000.00
	Shpenzime të internetit	€ 12,000.00	
Shpenzime të marrëveshjes me ATK	Shpenzime të marrëveshjes me ATK	€ 72,000.00	€ 72,000.00
Shpenzime Financiare	Shpenzime bankare dhe provizione	€ 1,500.00	€ 250,500.00
	Shpenzime bankare SWIFT tarifa	€ 1,000.00	
	Shpenzime të zotimit 2% dhe mirëmbajtje ligjore	€ 68,000.00	
	Shpenzime të interesit të kredisë	€ 180,000.00	
Shpenzime të Fluideve	Ad - blue	€ 80,000.00	€ 213,480.00
	Vajra për autobusë dhe fluid ftohës (Plan.kontrat.)	€ 117,000.00	
	Ujë të destiluar (2473l x 0.4€)	€ 10,080.00	
	Shampon për xhama (12 litra x 51 autobusë (+) x 12 muaj)	€ 6,400.00	
Shpenzime për IT	Telefona për Kuletën Dixhitale	€ 37,500.00	€ 147,200.00
	Pajisje për IT,		
	Pajisje për nevojat e zyrës së IT-së, dhe stafit të administratës. (pajisje pune për zyrën e IT, )	€ 65,000.00	
	Mirëmbajtja e web faqes së ndermarrjes	€ 3,700.00	
	Vazhdimi i Licences se sigurise	€ 2,000.00	
	Furnizim me Printer dhe Toner (ose me rent)	€ 5,000.00	
	Web Aplikacioni i Punesimit	€ 25,000.00	
	Diagnoze për vetura (universale) + OBD + 5 vite licensë	€ 8,000.00	
Mirëmbajtje mujore për programin në zyrën e financave të Trafikut Urban	€ 1,000.00		
Shpenzime për Arka Fiskale	Shpenzime të garancionit të arkave fiskale	€ 4,655.00	€ 14,971.25
	Abonim i shërbimeve fiskale	€ 7,766.25	
	Ndërrimi i modulit të memories për arkat fiskale	€ 2,550.00	
Shpenzime Administrative	Shpenzime administrative për zyre	€ 30,840.00	€ 30,840.00
Shpenzime për Paga	Shpenzime për pagat dhe shpërblyerjet e personelit	€ 5,714,285.71	€ 6,000,000.00
	Shpenzimet për pensione 5%	€ 285,714.29	
Shpenzime për Regjistrimin e Autobusëve dhe veturave zyrtare, GPS, pajisje komunikuese dhe shenjezim	Shpenzime për taksa rrugore	€ 6,000.00	€ 105,000.00
	Shpenzime për taksa komunale	€ 1,500.00	
	Shpenzime për taksa ekologjike	€ 2,500.00	
	Shpenzime për taksa administrative	€ 3,000.00	
	Shpenzime për kontrollim teknik të autobusëve dhe veturave zyrtare	€ 4,500.00	
	GPS për autobuset e ndermarrjes dhe operatorët privat, si dhe aplikacioni mobil për të gjitha linjat	€ 40,000.00	
	Shpenzimet në shenjezimin vertikal dhe horizontal në parking dhe objektin e TU-së, harta digjitale dhe fletushka informuese	€ 7,500.00	
Shpenzimin për sigurimin dhe regjistrimin e autobusëve	€ 40,000.00		
Shpenzime Operative të Sektorit të Mirëmbajtjes	Pjesë rezervë për autobusë	€ 650,000.00	€ 1,052,400.00
	Pjesë rezervë për ndërrues	€ 75,000.00	
	Material për autongyrosje	€ 20,000.00	
	Pllaka frenuese	€ 42,500.00	
	Perforcimi dhe rikonstruktimi i kanaleve + rregullimi i kanalizimit në kanalën I dhe II dhe kanalat e sallës II	€ 20,000.00	
	Bateri për autobusë (80 copë)	€ 24,000.00	
	Pajisje ditore, lubrifikantë, kushineta	€ 25,000.00	
	Pajisje për pastrimin e pjesëve të motorit	€ 6,500.00	
	Pajisje për pastrimin e filtrave të ajrit të motorit	€ 24,000.00	
	Sasi të metaleve për punishten e tornitorit	€ 5,000.00	
	Mirëmbajtja e veturave zyrtare	€ 10,000.00	
	Riparimi i sistemit të ventilimit në garazhe dhe riparimi i tubave për thithjen e gazrave në atmosfere	€ 6,000.00	
	Vegla dhe pajisje dhe makineri për punetoret aktual dhe të rinj	€ 50,000.00	
	Material për pastrimin e particle filterit	€ 3,000.00	
	Presë mekanike x 3	€ 2,400.00	
	Goma për sezonë verore për autobusë 140 c	€ 40,000.00	
	Goma për sezonë dimërore për autobusë 140 c	€ 40,000.00	
Frezë	€ 9,000.00		

Shpenzime per Sigurim Shendetesor dhe Kontrolle Sistematike Mjekesore	Shpenzime për kontroll sistematik mjekësor të punëtorëve të TU	€ 36,000.00	€ 236,000.00
	Shpenzime për sigurimin shëndetësor	€ 200,000.00	
Shpenzime për matje të kënaqshmërisë së konsumatorëve	Shpenzime për matje të kënaqshmërisë së konsumatorëve	€ 4,000.00	€ 4,000.00
Shpenzime Gjyqësore	Konsulence ligjore	€ 12,000.00	€ 218,500.00
	Shpenzime për taksa dhe procese gjyqësore	€ 201,000.00	
	Shpenzimet e noterimit dhe të pa parashikuara nga zyra ligjore	€ 5,500.00	
Shpenzime të përfaqësimit	Shpenzimet e përfaqësimit brenda vendit - reprezentacioni	€ 11,400.00	€ 58,900.00
	Shpenzime për trajnime dhe përfaqësime të brendshme dhe jashtë vendit	€ 47,500.00	
Shpenzime të mirëmbajtjes së objektit SSHM	Shpenzimet për mirëmbajtje të rrethojës së objektit dhe mbjelljen e fidaneve.	€ 20,000.00	€ 100,000.00
	Shpenzimet e higjienës për mirëmbajtje të autobusëve dhe për pastrimin e objektit.	€ 20,000.00	
	Rregullimin, servisimin e makinerisë në autolarje,	€ 2,000.00	
	AC klimatizim, Radiator për ngrohje, frigoriger, etj	€ 10,000.00	
	Rregullimin dhe funksionalizimin e kanaleve të kanalizimit, kanaleve të reshunave atmosferike duke përfshirë edhe ollukt.	€ 6,000.00	
	Rregullimi, servisi dhe testimi i derye kryesore të garazhës.	€ 9,000.00	
	Skele dhe Shkallë	€ 5,000.00	
	Mirëmbajtja e Tualet Kabinave dhe zbrazja e impianteve	€ 12,000.00	
	DDD	€ 10,000.00	
Mbulimi i Kanaleve	€ 6,000.00		
Shpenzime të Uniformave te Punetoreve	Shpenzime të Uniformave te Punetoreve	€ 30,000.00	€ 30,000.00
Shpenzime të Auditimit	Shpenzime të auditimit të jashtëm	€ 9,500.00	€ 9,500.00
Shpenzime të publikimit	Shpenzime të publikimit	€ 7,000.00	€ 7,000.00
Shpenzimet per Ujë te ambalazhuar	Shpenzimet per Ujë te ambalazhuar dhe qumesht, çaj dhe kafe	€ 12,000.00	€ 12,000.00
Shpenzime për mbrojtjen në punë	Shpenzime për pajisje për mbrojtjen në punë, material për kutit e ndihmës së parë,	€ 10,000.00	€ 10,000.00
Shpenzime për posta	Shpenzimet e postave të rëndomta dhe te shpejta	€ 250.00	€ 250.00
Shpenzime tjera te paparashikuara	Shpenzime tjera	€ 10,000.00	€ 10,000.00
Marreveshjet PSC	Qeraja në aeroport, stacion të autobusëve dhe marrëveshja me linjën 1 me Fushë Kosovën	€ 18,000.00	€ 18,000.00
Shpenzime të humbjeve, dëmtimeve dhe mjeteve metalike false	Shpenzime të ndryshme të humbjeve dëmtimeve dhe vjedhjeve	€ 5,000.00	€ 5,000.00